



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.662/20
699/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Blerim Dina - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik “Pe-Vla-Ku” SH.P.K- Dega në Kosovë-Prishtinë dhe OE “Euroasphalt” SH.P.K - Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE SH “Drini Company” SH.P.K- Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores –Tranziti i ri” me nr. të prokurimit: 632-19-2998-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “KK-Gjakovë” (KK.GJ), më datën: 28.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “Pe-Vla-Ku” SH.P.K- Dega në Kosovë-Prishtinë dhe OE “Euroasphalt” SH.P.K- Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores –Tranziti i ri” me nr. të prokurimit:632-19-2998-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KK-Gjakovë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores –Tranziti i ri” me nr. të prokurimit:632-19-2998-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK-Gjakovë” (KK.GJ), dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konfirmon dispozitat ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “Pe-Vla-Ku” SH.P.K- Dega në Kosovë-Prishtinë dhe OE “Euroasphalt” SH.P.K- Gjakovë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

AR SY ET IM

Operatorët ekonomik ankues “Pe-Vla-Ku” SH.P.K - Dega në Kosovë-Prishtinë dhe OE “Euroasphalt” SH.P.K- Gjakovë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 14.09.2020, me nr. 662/20 dhe me 21.09.2020 me nr. 699/20 kundër B58- njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë OE: SH “Drini Company” SH.P.K- Prizren , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores –Tranziti i ri ” me nr. të prokurimit:632-19-2998-5-1-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK-Gjakovë” (KK.GJ),duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 27, 28, 51, 56, 57, 59, 60, 64, 68, 69, 70 dhe 71 të LPP-së, si dhe nenin 2, 26, 27, 39.8 dhe 41 të RRUOPP-së, te ankesa me nr. 662/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 59, 60, 64, 68, 69, 72, 108/a të LPP-së, si dhe neni 39.8 të RRUOPP-së, te ankesa me nr. 699/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë 29.09.2020 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 02.10.2020, lidhur me pretendimin ankimor të ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Pe-Vla-Ku” SH.P.K - Dega në Kosovë - Prishtinë
Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin nr. 2 të OE ankues “PE-VLA-KU” SH.P.K se me datën 07.09.2020, Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës në sistemin elektronik e-Prokurim ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues, ku përsëri fitues e ka shpallur kompaninë "Drini Company" Sh.P.K. si dhe pas marrjes së Raportit të Rivlerësimit të VI nga AK: Komuna e Gjakovës kemi parë që AK: Komuna e Gjakovës nuk ka bërë vlerësim në mënyrë të barabartë dhe të drejtë. Dhe atë për udhëheqësen e punishtes znj. Mimoza

Mehmetaj. Vlen të tregohet se inxh. Mimoza Mehmetaj ka qenë edhe vazhdon të bashkëpunoj me kompaninë tonë që nga viti 2015, edhe pas kësaj periudhe kemi vazhduar bashkëpunimin tonë për disa projekte.

Përgjigje në pretendimin nr. 1

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së.

Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH.nr.346, 348 /20 datë 10.07.2020.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues të gjithë dokumentacionin e ofruar sipas kërkesës për sqarim e ka dorëzuar konform kërkesës duka ua vazhduar afatin e kontratave të punës sipas kërkesës duke e pas parasysh procedurat e zhvilluara për këtë aktivitet të prokurimit jo ma faj të operatorëve ekonomik. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin nr. 2 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K se me datën 07.09.2020, Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës në sistemin elektronik e-Prokurim ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues, ku përsëri fitues e ka shpallur kompaninë "Drini Company" Sh.P.K. si dhe pas marrjes së Raportit të Rivlerësimit të VI nga AK: Komuna e Gjakovës kemi parë që AK: Komuna e Gjakovës nuk ka bërë vlerësim në mënyrë të barabartë dhe të drejtë. Dhe atë tek pika: Një inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose mastar i inxhinieres mekanike, drejtimi komunikacion (transport) me minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit - OE ka sjellë inxhinieren me diplomë të ndërtimtarisë – dega infrastrukturës rrugore ku sipas AK nuk e plotësojmë kërkesën e parashtruar.

Ky pretendim nuk qëndron sepse kjo është vetëm një dallim dialekti në mes të dy vendeve, që e kanë kuptimin e njëjtë dhe që kanë studiuar në sistemin e njëjtë shkollor.

Përgjigje në pretendimin nr. 2

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues, duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se OE ankues në ofertën e tij për: Inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose mastar i inxhinieres mekanike, drejtimi komunikacion (transport) ka prezantuar anëtarin e stafit: OLSI NJAZI VOKA datëlindja 25.12.1983, Dibër Me titull: inxhinier ndërtimi: Profili Infrastrukturë e Transportit të lëshuar nga Universiteti Politeknik Tiranë me vendim të komisionit

shtetëror dt. 17 korrik 2009 si dhe: LICENCË K.1332/1 regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 30.06.2015. NË PROJEKTIM

Kat. 3 a - Objekte civile- industriale –turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

Kat. 6 a – rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

c- shtresa rrugore e sistemim- asfaltim,

Kat. 7 a- Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

b- Sinjalistikë në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.

Eksperti shqyrtues pas analizës së këtij dokumentacionit konstaton se anëtar i personelit udhëheqës OLSI VOKA Me titull: Inxhinier Ndërtimi: Profili Infrastrukturë e Transportit dt. 17 korrik 2009 i plotëson të gjitha kriteret të kërkuara sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë të pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Një inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimum pesë vite përvojë pune pas diplomimit. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin nr. 3 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K se ankues se Operatori Ekonomik SH. Drini Comapny Sh.P.K i cili është shpallur i përgjegjshëm me çmimin: 2,999,470.37€. Gjatë kontrollimit të dosjes së tij ne kemi hasur në shumë parregullsi nga ky operator ekonomik.

- OE në mbështetjen e tij bankare siç është kërkuar në dosjen e tenderit nuk e ka të saktë emërtimin e projektit si në dosje "Ri-Shpallje Nderimi i Qarkores – Tranziti i Ri (Në gjuhën angleze: Re Tender Construction of Circular - Në tranzit) por e ka me titull të projektit të mëhershëm Ndërtimi i Qarkores - Tranziti i Ri (Në gjuhën angleze si e ka në Mbështetje Bankare: Construction of Qarkores - Tranziti i Ri) gjë e cila po bije në kundërshtim me dosjen e tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktues.

Përgjigje në pretendimin nr. 3

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues, duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së.

Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH.nr.829/19 datë 27.12.2019, ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e eksperti teknik të

prokurimit vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave është bërë konform nenit 59 të LPP-së.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin nr. 4 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K se ankues së Gjatë kontrollimit të dosjes së tenderit të Operatorit Ekonomik të lartë cekur, kemi has në kontrata të cilat nuk janë përputhura me listën e ofruar nga Operatori Ekonomik Sh. Drini Company Sh.P.K. :- Operatori Ekonomik gjatë kontrollimit të dosjen e tenderit të kontratave për punë të ngjashme kemi vërejtur se kontrata: Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2015 -2016, kjo kontratë nuk figuron si kontrata të tjera por që vërejmë se Kontrata: Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2014/2015 është e përsëritur dy herë në mënyrën e njëjtë kurse kontrata Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2015 - 2016 nuk figuron në dosjen e tij për punë të ngjashme dhe as nuk është pranimit teknik, veçmas një referencë e lëshuar në 03.11.2017, por që kjo kontratë nuk duhet të pranohet asi si kontrata e valide e as si referencë pasi që është e vitit 2014/2015 dhe që në dosje të tenderit kontratat për punë të ngjashme duhet me qenë të tri (3) viteve të fundit. Tek kjo listë gjithashtu vërejmë se Operatori Ekonomik SH. Drini Company Sh.P.K ka paraqitur kontratën Rikonstruktimi i Rrugës Kukës - Shishtavec, Lot 2 me vlerë 4,126,156.78€, ku në këtë projekt Sh. Drini Company SH.P.K nuk është lideri por vetëm si partner i dytë me 40%, pasi që është partneri i dytë vlara e kontratës nuk llogaritet 4,126,156.78€ por vetëm 40% i tij i cili i bije të ketë vlerën 1,600.000.00€.

Kjo i bije ky Operator Ekonomik nuk i përmbush kërkesën sipas dosjes së tenderit ku kërkohen që Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimi të Njoftimit për kontratën. Në një vlerë se jo më pak se 5.000.000.00€ gjë që Operatori Ekonomik Sh. Drini Company nuk e përmbush këtë kriter dhe vlara e kontratave për punë të ngjashme mbërrin: 4,615,203.3€.

Përgjigje në pretendimin nr. 4

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së.

Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH.nr.85/20 datë 11.03.2020 ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e eksperti teknik të prokurimit

vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 5

Lidhur me pretendimin nr. 5 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K se ankues se Duke u bazuar në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 si dhe duke u bazuar në neni 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligji i Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, Ligjin 05/L092, vërejmë se Inxhinieri i prezantuar i komunikacionit nuk i përmbush kërkesat sipas dosjes së tenderit. Me dosjen e tenderit kërkohet: Një Inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike - drejtimi komunikacion (transport) me minimumi pesë [5] vite përvojë pune pas diplomimit. Ndërsa Operatori Ekonomik Sh Drini Company SH.P.K, ka ofruar diplomë Bachelor të komunikacionit rrugor dhe transportit gjë që nuk është inxhinier që i plotëson kriteret për këtë tender.

Përgjigje në pretendimin nr. 5

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së.

Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimi i PSH.nr.400/19 dhe 419/19 datë 06.09.2019; Vendimi i PSH.nr.621/19 datë 07.11.2019; Vendimin e PSH.nr.829/19 datë 27.12.2019 dhe Vendimin e PSH.nr.85/20 datë 11.03.2020, ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e eksperti teknik të prokurimit vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 6

Lidhur me pretendimin nr. 6 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K se ankues se - Operator ekonomik ka paraqitur kontratat e punëtorëve, ku të gjitha kontratat janë me noterizim të njëjte. Megjithatë nuk janë kërkuar është rast për tu shqyrtuar se pse të gjitha kanë klauzolën e noterizimit të njëjtë. Klauzola e noterizimit është në të gjitha e njëjtë si për nga forma ashtu edhe për nga numri rendor i saj Nr.i LPP-së 3172/2019.

Përgjigje në pretendimin nr. 6

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së.

Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH.nr.829/19 datë 27.12.2019 dhe Vendimin e PSH.nr.85/20 datë 11.03.2020, ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e eksperti teknik të prokurimit vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 7

Lidhur me pretendimin nr. 7 të OE “PE-VLA-KU” SH.P.K se ankues se Sipas Neni 28 i LPP - së - Specifikimet Teknike të Ligjit nr. 04/L-042 i Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, Ligjin 05/1092, OE i mungojnë deklarata për specifikime teknike dhe specifikacionet teknike të detyrueshme, gjë e cila duhet të ishin në dosje.

Përgjigje në pretendimin nr. 7

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH.nr.829/19 datë 27.12.2019, ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e eksperti teknik të prokurimit vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave është bërë konform nenit 59 të LPP-së.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Euroasphalt” SH.P.K- Gjakovë

Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin nr. 1 të OE "EUROASPHALT" SH.P.K se ankues se AK-ja ka rekomanduar për kontratë OE i cili është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka përmbush të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, ku tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike -drejtimi komunikacion (transport) me minimumi (pesë) vite përvojë pune pas diplomimit, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar Bachelor të komunikacionit rrugor dhe transportit, e këtë fakt e ka konstatuar edhe eksperti shqyrtues në ekspertizën e tij dhe paneli shqyrtues me vendimin përkatës Nr, 400, 419/19 (ë datës 09.08.2019, ndërsa ishte konstatuar dhe konfirmuar papërgjegjshmëria e këtij operatori ekonomik edhe me vendimin e mëhershëm të OSHP-së Nr.829/19, ku në faqen 11-12 paneli shqyrtues kishte konstatuar, citojmë "se kriteri i vendosur nga AK-ja nuk mund të cilësohet shkelje e vogël sepse është kriter eliminues dhe shumë kompani kanë mundur të mos e dorëzojnë ofertën e tyre sepse në stafin e tyre nuk e kanë pasur inxhinierin e diplomuar të komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike-drejtimi komunikacion (transport) me minimumi pesë vite përvojë pune pas diplomimit", mbarim citati.

Ky pretendim dhe ky fakt është konstatuar si çështje e gjykuar – Res Judicata sipas nenit 105 paragrafi 2.16 i LPP-së, edhe me vendimin tjetër pasues të OSHP-së Nr.85/20 të dt. 11.03.2020. Gjithashtu edhe në vendimin e fundit të OSHP-se nr. 346-348/20 i dt. 10.07.2020 është konstatuar se pretendimi ynë ankimor është i bazuar dhe ky pretendim është cilësuar si çështje e gjykuar (Res-judicata), mirëpo edhe pas të gjitha këtyre vendimeve të OSHP-së ku është ri konfirmuar papërgjegjshmëria e OE të rekomanduar për kontratë, AK-ja po vazhdon të na diskriminoj neve si OE i përgjegjshëm ndërsa po e favorizon OE e rekomanduar për kontratë një OE i cili në disa vendime është cilësuar si i papërgjegjshëm, duke mos i respektuar fare vendimet e OSHP-së edhe pse AK-ja është e detyruar ti respektoj këto vendime.

Pra autoriteti kontraktues edhe me këtë vlerësim ka vepruar plotësisht në kundërshtim me vendimet e lartcekura të OSHP-së duke e rekomanduar për kontratë OE Drini Company SH.P.K, edhe pse është konfirmuar papërgjegjshmëria e këtij operatori ekonomik me vendimet e një organi më të lartë administrativ siç është OSHP-ja.

Përgjigje në pretendimin nr. 1

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimi i PSH.nr.400/19 dhe 419/19 datë 06.09.2019; Vendimi i PSH nr.621/19 datë 07.11.2019; Vendimin e PSH.nr.829/19 datë 27.12.2019, Vendimin e

PSH.nr.85/20 datë 11.03.2020 dhe Vendimin e PSH.nr.346,348/20 datë 10.07.2020, ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit teknik të prokurimit vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin nr. 2 të OE "EUROASPHALT" SH.P.K se ankues se në vendimin e OSHP-së Nr.85/20 të dt.11.03.2020 është konstatuar se edhe kontrata e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë me titull "reconstruction ofroad Kukës Shishtavec Lot 2 Kukës Region me Nr. CĖC/ICB/2013/ĖL- rec-54-1 është lidhur me dt.28.04.2014 dhe ka përfunduar me dt. 30.06.2016 dhe nuk mund të merret parasysh, me përjashtim të situatës të fundit eventuale, e të cilin nuk e ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë, prandaj kjo kontratë nuk mund të merret parasysh si valide dhe në kuadër të tri viteve të fundit siç është kërkuar nga ana e AK-së, sepse njoftimi për kontratë është bërë me dt. 10.05.2019, ndërsa faktin se pretendimi ynë është i bazuar e ka vërtetuar edhe një herë paneli shqyrtues i OSHP-së në vendimin nr. 346-348/20 i dt. 10.07.2020, andaj është për tu habitur se si mundet që përsëri të rekomandohet për kontratë një OE papërgjegjshmërinë e të cilit e ka konstatuar paneli shqyrtues në vendimin e fundit dhe në vendimet tjera të mëhershme. Ky veprim i AK-së nuk mund të merret ndryshe përveç se favorizim i hapur ndaj OE të rekomanduar për kontratë, diskriminim i kompanisë tonë dhe mos respektim i vendimeve të organit më të lartë në këtë rast OSHP-së.

Përgjigje në pretendimin nr. 2

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin qe kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së.

Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH.nr.829/19 datë 27.12.2019, Vendimin e PSH.nr.85/20 datë 11.03.2020 dhe Vendimin e PSH.nr.346,348/20 datë 10.07.2020, ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit teknik të prokurimit vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin nr. 3 të OE "EUROASPHALT" SH.P.K se ankues se OE i rekomanduar për kontratë Drini Company Shpk" sh.p.k nuk ka ofruar dëshmi konkrete edhe për projektet si në vijim: I. Asfaltimi i rrugës Pastasel -Kaznik me Nr. Prot: 623.14.018.521 Autoriteti K.K Rahovec. Vlera e kontratës 20,640.00 €, e filluar me 26.06.2014 e përfunduar 19.07.2016, nuk ka dëshmi për shumën e realizimit-pagesa për vitin 2016.

2.Referenca e dëshmuar e kontratës Rehabilitimi me asfalt i rrugëve ne komunën e Prizrenit 19.97 për njësi, nuk përputhet me titullin e kontratës, është lëshuar për :Adoptimi i pompave me asfalt ne qytet dhe fshatra të Prizrenit.

3. Nuk është vulosur referenca e lëshuar me dt. 07.03.2019 nga Investitori MI-se ne kontratën" Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve Nacionale dhe Rajonale për vitin 2016-2017 Regjioni Prizrenit -2 me Nr. Prot MI-14/051/211

4. Nuk është vulosur referenca e lëshuar me dt :07.03.2019 nga Investitori MI-se ne kontratën "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve Nacionale dhe Rajonale për vitin 2017-2018 Regjioni Prizrenit -2 me Nr. Prot. MI 205/17/5353/215.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë vërehet që OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar edhe kërkesën në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional ku është kërkuar "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 5.000.000,00€, ne rast konzorciumi

lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme.

OE i rekomanduar për kontratë ka gabime aritmetikore ashtu siç e ka cekur kryesuesi i komisionit të vlerësimit tek lëshesa pllakore në stacionazhet 1+416 km dhe 2+922 km të punët e armimit, nuk është mbledh pozicioni V.I. Furnizimi, punimi dhe vendosja e armaturës nga $\Phi 10$ mm deri në $\Phi 16$ mm: $21368.90 \text{ kg} \times 0.80 = 17,095.12$ €.

Tek rekapitullimi i lëshesës pllakore totali del gjithsej me TVSH 69,795.72 € e jo 52,700.60 € sikur në ofertë. ne total kontrata nuk është 2,999,470.37 € por 3,016,565.50 €.

Përgjigje në pretendimin nr. 3

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar ne rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit , neni 16, rastet e unifikuara par. 2)dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 te LPP-së.

Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH.nr.346, 348/20 datë: 10.07.2020 ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit teknik të prokurimit vjen në përfundim se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin nr. 4 të OE "EUROASPHALT" SH.P.K se ankues se OE i rekomanduar për kontratë "Drini Company" sh.p.k nuk e ka plotësuar edhe kërkesën e nenit 8.1&8.2 të FTD-së përkitazi me Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, ku është kërkuar "Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 500.000,00 € asete likuide financiare (për shembull në llogarinë bankare) ose të paktën 500.000,00 € qasje për kredi në dispozicion.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një deklaratë nga Banka Raiffeisen Bank, ku shkruan se mundet me mbështet kompaninë për kredi nëse i plotëson kriteret e brendshme të Bankës, mirëpo kjo deklaratë nuk është në përputhshmëri me kërkesën e FTD-së dhe nuk po konfirmon qasjen në dispozicion për kredi, pasi që ky dokument mund të lëshohet secilit dhe secili person juridik apo fizik mundet të marrë kredi nëse i plotëson kushtet dhe kriteret e brendshme të bankës. Por në këtë rast nuk po konfirmohet se i plotëson OE i rekomanduar për kontratë kushtet për kredi në vlerën e kërkuar.

Prandaj për të sqaruar këtë dokument të OE të rekomanduar për kontratë AK-ja ka mundur shumë lehtë të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së nga Banka e cila e ka lëshuar këtë dokumente dhe të vërtetohet se a posedon "Drini company" Sh.p.k. mjete likuide apo qasje të pakushtëzuar në kredi. Pasi që këtë veprim AK-ja nuk e ka ndërmarr gjatë rivlerësimit të ofertave kërkojmë që të detyroni AK tani pas ankesës të kërkojë sqarimet nga Banka, sipas dispozitave që i cekëm më lartë. Për të bërë ekzaminim, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave AK-ja duhet të bëjë kërkesë drejtpërdrejtë nga banka për të konfirmuar dëshminë e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë dhe të vërtetohet saktë se a është kjo dëshmi sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Përgjigje në pretendimin nr. 4

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtojë si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së.

Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH .nr. 346, 348/20 datë: 10. 07. 2020 ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e eksperti teknik të prokurimit vjen në përfundim se ky pretendim është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 5

Lidhur me pretendimin nr. 5 të OE “EUROASPHALT” SH.P.K se ankues në lidhje me arsyen e AK-së për eliminimin tonë ju sqarojmë se arsyetimi i AK-së është i pa bazuar pasi që ne e përmbushim kërkesën në lidhje me 60% kontrata të ngjashme, sepse AK-ja tek lista e projekteve të prezantuar nga ne, nuk e ka llogaritur fare kontratën me titull Ndërtimi Ekzekutimi i pllatos së Qendrës Tregtare-Prizren e cila kontratë ka shifrën prej 251,573.30 €, ndërsa në kuadër të kësaj kontratë hyn edhe aneks kontrata me titull Punimi i pllatos (parkingut) me asfalt për Qendrën Tregtare-Prizren e cila e ka vlerën prej 80,000.00 €, e ku të dyja këto e kapin vlerën prej 331,573.30 €, vlerë kjo që dëshmon se lideri e plotëson kërkesën e FDT-së prej 60 % të vlerës së kontratave. Ju sqarojmë se gjatë dorëzimit të ofertës ka ndodhur një lëshim teknik nga ana jonë ku nuk është bashkangjitur referenca ose pranimi teknik i kësaj kontrate, mirëpo AK-ja nëse ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me kontratën e lartpërmendur atëherë ka mundur që në bazë të dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-s të kërkojë sqarime shtesë nga ne dhe jo automatikisht të na eliminojë.

Në lidhje me këtë kontratë ekzistojnë referenca dhe procesverbali i pranimit teknik i aneks kontratës, ndërsa po ashtu ekzistojnë edhe dëshmitë bankare me të gjitha pagesat që janë bërë për këtë kontratë.

Përgjigje në pretendimin nr. 5

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se Autoriteti kontraktuese ka qenë i obliguar të veprojë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-se si dhe nenin 39.8 të RRUOPP në bazë të cilin AK-ja duhet të bëjë Sqarimin e Tenderëve.

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-se
Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara	Mund të kërkojnë informata sqaruese	69

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 6

Lidhur me pretendimin nr. 6 të OE “EUROASPHALT” SH.P.K se ankues në Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Ne raportin e rivlerësimit të VI me radhë vërehet edhe një mospërputhje e mendimeve të anëtarëve të komisionit, sepse Kryesuesi i komisionit ka rekomanduar që të anulohet në tërësi ky aktivitet i prokurimit, ndërsa dy anëtarët tjerë kanë rekomanduar që të rekomandohet për kontratë OE Drini Company dhe duke e cilësuar si devijim të vogël ofrimin e diplomës bachelor në vend të diplomës Inxhinier të komunikacionit. Te dy anëtarët e komisionit e japin një mendim ku konstatojnë se OE “Drini Company” sh.p.k. është operatori ekonomik më i përgjegjshëm për zbatim të këtij projekt, pra edhe këta dy anëtarë të komisionit faktikisht e pranojnë që OE Drini nuk është i përgjegjshëm por thonë se është më i përgjegjshmi. Në raport me OE Drini Company dy anëtarët e komisionit kanë shpreh subjektivizëm ekstrem duke mos i bërë përshtypje dokumentet të cilat nuk janë në rregull, as vula në referencë e as diploma, e as vendimet e një organi më të lartë siç është OSHP-ja që ka konstatuar se OE Drini Company është i papërgjegjshëm.

Përgjigje në pretendimin nr. 6

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se ne baze të raportit të rivlerësimit të VI të tenderëve ka një mospërputhje e mendimeve përfundimtare të anëtarëve të komisionit, si: Kryesuesi i komisioni për Ri-vlerësimin e VI-të, z. Arbër Ramadani, ka qenë i mendimit se asnjëri nga Operatorët ekonomik nuk i plotëson kriteret e kërkuara nga Autoriteti kontraktues, prandaj ka kërkuar që tenderi të ANULOHEJ DHE TË SHKOHET ME RI-TENDERIM, kurse dy anëtarët tjerë të Komisionit për Ri-vlerësimin e VI-të, z. Luan Nimani dhe z. Berat Bejtullahu, kanë qenë të mendimit se Operatori Ekonomik MË I PËRGJEGJSHËM me çmimin më të ulët është SH. Drini Company SH.P.K., Ersan Mazreku Lam 2/1, - 20000, PRIZREN, të cilin e rekomanduan me dhënie të kontratës. Andaj rekomandimi i kryesuesit të komisionit ka qenë i drejtë kurse rekomandimi i të dy anëtarëve të komisionit ka qenë jo real sepse janë vetëm dy opsione të përgjegjshëm ose i pa përgjegjshëm kurse vlerësimi MË I PËRGJEGJSHËM nuk ekziston sipas LPP-së. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen pjesërisht si të bazuara, të anulohet Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 04.09.2020 dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim**.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 02.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik “Pe-Vla-Ku” SH.P.K- Dega në Kosovë-Prishtinë me datë 05.10.2020, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Data: 05.10.2020

PËR: Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik "OSHP"

NGA: "PE-VLA-KU" SH.P.K - Dega në Kosovë

PËRGJEGJIJA NË MENDIMIN E EKSPERTITI SHQYRTUES

Duke u bazuar ne nenin 115 paragrafin 1 i Ligjit te Prokurimit Publik te Republikës Kosovës 04/L- 042, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, Ligjin 05/L092, ne Operatori Ekonomik "PE-VLA-KU" Sh.P.K - Dega ne Kosovë si parashtrues i ankesës me 662/20 te parashtruar me datën: 14.08.2020, pajtohem i pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

"PE-VLA-KU" Sh.P.K - Dega në Kosovë

PËRFAQËSUES PËR KOSOVË



Operatori Ekonomik "Euroasphalt" SH.P.K- Gjakovë me datë 05.10.2020, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

PËRGJIGJE NË EKSPERTIZË NR. 662,699/20

Të nderuar konfirmojmë pranimin e ekspertizës me Nr. 662,699/20 të dt. 02.10.2020 dhe njëkohësisht pajtohem me mendimin dhe rekomandimin e ekspertit të OSIIP-së se ka aktivitet duhet të kthehet në rivlerësim. Prandaj kërkojmë edhe nga paneli shqyrtues që të merr vendim që ankesa jonë të aprovohet si e bazuar dhe se përgjegjshmëria e OE të rekomanduar për kontratë është vërtetuar dhe konfirmuar nga vendimet e mëparshme të panelit shqyrtues ashtu siç e ka cekur eksperti i OSHP-së dhe në këto rrethana dhe me këto dëshmi kërkojmë nga paneli shqyrtues që të lëshojë urdhëresë për mos zbatim të vendimeve të OSHP-së.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave,

raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Pe-Vla-Ku" SH.P.K - Dega në Kosovë – Prishtinë, se me datën 07.09.2020, autoriteti kontraktues në sistemin elektronik e-Prokurim ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues, ku përsëri fitues e ka shpallur kompaninë "Drini Company" Sh.P.K. si dhe pas marrjes së raportit të rivlerësimit kemi parë që AK nuk ka bërë vlerësim në mënyrë të barabartë dhe të drejtë. Dhe atë për udhëheqësen e punishtes znj. Mimoza Mehmetaj. Vlen të tregohet se inxh. Mimoza Mehmetaj ka qenë edhe vazhdon të bashkëpunoj me kompaninë tonë që nga viti 2015, edhe pas kësaj periudhe kemi vazhduar bashkëpunimin tonë për disa projekte.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Pra, ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH.nr.346, 348 /20 datë 10.07.2020.

Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues të gjithë dokumentacionin e ofruar sipas kërkesës për sqarim e ka dorëzuar konform kërkesës duka ua vazhduar afatin e kontratave të punës sipas kërkesës duke e pas parasysh procedurat e zhvilluara për këtë aktivitet të prokurimit jo ma faj të operatorëve ekonomik. Prandaj, ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues "Pe-Vla-Ku" SH.P.K, se me datën 07.09.2020 AK në sistemin elektronik e-Prokurim ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, ku përsëri fitues e ka shpallur kompaninë "Drini Company" Sh.P.K. si dhe pas marrjes së Raportit të Rivlerësimit të VI nga AK: Komuna e Gjakovës kemi parë që AK: Komuna e Gjakovës nuk ka bërë vlerësim në mënyrë të barabartë dhe të drejtë. Dhe atë tek pika: Një inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose mastar i inxhinieres mekanike, drejtimi komunikacion (transport) me minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit - OE ka sjellë inxhinieren me diplomë të ndërtimtarisë – dega infrastrukturës rrugore ku sipas AK nuk e plotësojmë kërkesën e parashtuar. Ky pretendim nuk qëndron sepse kjo është vetëm një dallim dialekti në mes të dy vendeve, që e kanë kuptimin e njëjtë dhe që kanë studiuar në sistemin e njëjtë shkollor.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues në ofertën e tij për: Inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose mastar i inxhinieres mekanike, drejtimi komunikacion (transport) ka prezantuar anëtarin e stafit: OLSI NJAZI VOKA datëlindja 25.12.1983, Dibër Me titull: inxhinier ndërtimi: Profili Infrastrukturë e Transportit të lëshuar nga Universiteti Politeknik Tiranë me vendim të komisionit shtetëror dt. 17 korrik 2009 si dhe: LICENCË K.1332/1 regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 30.06.2015. NË PROJEKTIM Kat. 3 a - Objekte civile- industriale –turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

Kat. 6 a – rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

c- shtresa rrugore e sistemim- asfaltim,

Kat. 7 a- Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

b- Sinjalistikë në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.

Pra, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se anëtari i personelit udhëheqës OLSI VOKA Me titull: Inxhinier Ndërtimi: Profili Infrastrukturë e Transportit dt. 17 korrik 2009 i plotëson të gjitha kriteret të kërkuara sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë të pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Një inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimum pesë vite përvojë pune pas diplomimit. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "PE-VLA-KU" SH.P.K, se OE i rekomanduar për kontratë SH. Drini Comapny Sh.P.K i cili është shpallur i përgjegjshëm me çmimin: 2,999,470.37€. Gjatë kontrollimit të dosjes së tij ne kemi hasur në shumë parregullsi nga ky operator ekonomik. OE në mbështetjen e tij bankare siç është kërkuar në dosjen e tenderit nuk e ka të saktë emërtimin e projektit si në dosje "Ri-Shpallje Nderimi i Qarkores – Tranziti i Ri (Në gjuhën angleze: Re Tender Construction of Circular - Në tranzit) por e ka me titull të projektit të mëhershëm Ndërtimi i Qarkores - Tranziti i Ri (Në gjuhën angleze si e ka në Mbështetje Bankare: Construction of Qarkores - Tranziti i Ri) gjë e cila po bije në kundërshtim me dosjen e tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktues.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Pra, ky pretendim është shqyrtuar më parë në vendimin PSH.nr.829/19 datë 27.12.2019, ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e eksperti teknik të prokurimit vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Andaj, ky pretendim është i pa bazuar.

Pastaj, sa i përket pretendimit të OE ankues "PE-VLA-KU" SH.P.K, se gjatë kontrollimit të dosjes së tenderit të operatorit ekonomik të lartë cekur, kemi has në kontrata të cilat nuk janë përputhura me listën e ofruar nga operatori ekonomik Sh. Drini Company Sh.P.K.;- Operatori Ekonomik gjatë kontrollimit të dosjes së tenderit të kontratave për punë të ngjashme kemi vërejtur se kontrata: Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2015 -2016, kjo kontratë nuk figuron si kontrata të tjera por që vërejmë se Kontrata: Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës

së Kosovës 2014/2015 është e përsëritur dy herë në mënyrën e njëjtë kurse kontrata Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2015 - 2016 nuk figuron në dosjen e tij për punë të ngjashme dhe as nuk është pranimit teknik, veçmas një referencë e lëshuar në 03.11.2017, por që kjo kontratë nuk duhet të pranohet as si kontrata e valide e as si referencë pasi që është e vitit 2014/2015 dhe që në dosje të tenderit kontratat për punë të ngjashme duhet me qenë të tri (3) viteve të fundit. Tek kjo listë gjithashtu vërejmë se Operatori Ekonomik SH. Drini Company Sh.P.K ka paraqitur kontratën Rikonstruktimi i Rrugës Kukës - Shishtavec, Lot 2 me vlerë 4,126,156.78€, ku në këtë projekt Sh. Drini Company SH.P.K nuk është lideri por vetëm si partner i dytë me 40%, pasi që është partneri i dytë vlere e kontratës nuk llogaritet 4,126,156.78€ por vetëm 40% i tij i cili i bje të ketë vlerën 1,600.000.00€. Kjo i bje ky Operator Ekonomik nuk i përmbush kërkesën sipas dosjes së tenderit ku kërkohen që Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimi të Njoftimit për kontratën. Në një vlerë se jo më pak se 5.000.000.00€ gjë që Operatori Ekonomik Sh. Drini Company nuk e përmbush këtë kriter dhe vlere e kontratave për punë të ngjashme mbërrin: 4,615,203.3€.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 te LPP-së. Pra, ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH.nr.85/20 datë 11.03.2020 ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e eksperti teknik të prokurimit vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Prandaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi tjetër i OE ankues “PE-VLA-KU” SH.P.K se duke u bazuar në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2, si dhe duke u bazuar në neni 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligji i Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, Ligjin 05/L092, vërejmë se Inxhinieri i prezantuar i komunikacionit nuk i përmbush kërkesat sipas dosjes së tenderit. Me dosjen e tenderit kërkohet: Një Inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike - drejtimi komunikacion (transport) me minimumi pese [5] vite përvojë pune pas diplomimit. Ndërsa Operatori Ekonomik Sh Drini Company SH.P.K, ka ofruar diplomë Bachelor të komunikacionit rrugor dhe transportit gjë që nuk është inxhinier që i plotëson kriteret për këtë tender.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 te LPP-së. Pra, ky

pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimi i PSH.nr.400/19 dhe 419/19 datë 06.09.2019; Vendimi i PSH.nr.621/19 datë 07.11.2019; Vendimin e PSH.nr.829/19 datë 27.12.2019 dhe Vendimin e PSH.nr.85/20 datë 11.03.2020, ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit teknik të prokurimit vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "PE-VLA-KU" SH.P.K se operatori ekonomik ka paraqitur kontratat e punëtorëve, ku të gjitha kontratat janë me noterizim të njëjtë. Megjithëse nuk janë kërkuar është rast për tu shqyrtuar se pse të gjitha kanë klauzolën e noterizimit të njëjtë. Klauzola e noterizimit është në të gjitha e njëjtë si për nga forma ashtu edhe për nga numri rendor i saj Nr.i LPP-së 3172/2019.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Pra, ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH.nr.829/19 datë 27.12.2019 dhe Vendimin e PSH.nr.85/20 datë 11.03.2020, ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit teknik të prokurimit vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Prandaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues "PE-VLA-KU" SH.P.K, se sipas nenit 28 të LPP-së - Specifikimet Teknike të Ligjit nr. 04/L-042 i Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, Ligjin 05/1092, OE i mungojnë deklaratat për specifikime teknike dhe specifikacionet teknike të detyrueshme, gjë e cila duhet të ishin në dosje.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH.nr.829/19 datë 27.12.2019, ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit teknik të prokurimit vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Kurse, lidhur me pretendimin e OE ankues "Euroasphalt" SH.P.K- Gjakovë, se AK-ja ka rekomanduar për kontratë OE i cili është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka përmbush të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe

të njoftimit për kontratë, ku tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike -drejtimi komunikacion (transport) me minimumi (pesë) vite përvojë pune pas diplomimit, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar Bachelor të komunikacionit rrugor dhe transportit, e këtë fakt e ka konstatuar edhe eksperti shqyrtues në ekspertizën e tij dhe paneli shqyrtues me vendimin përkatës Nr, 400, 419/19 (ë datës 09.08.2019, ndërsa ishte konstatuar dhe konfirmuar përgjegjëshmëria e këtij operatori ekonomik edhe me vendimin e mëhershëm të OSHP-së Nr.829/19, ku në faqen 11-12 paneli shqyrtues kishte konstatuar, citojmë "se kriteri i vendosur nga AK-ja nuk mund të cilësohet shkelje e vogël sepse është kriter eliminues dhe shumë kompani kanë mundur të mos e dorëzojnë ofertën e tyre sepse në stafin e tyre nuk e kanë pasur inxhinierin e diplomuar të komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike-drejtimi komunikacion (transport) me minimumi pesë vite përvojë pune pas diplomimit", mbarim citati. Ky pretendim dhe ky fakt është konstatuar si çështje e gjykuar – Res Judicata sipas nenit 105 paragrafi 2.16 i LPP-së, edhe me vendimin tjetër pasues të OSHP-së Nr.85/20 të dt. 11.03.2020. Gjithashtu edhe në vendimin e fundit të OSHP-se nr. 346-348/20 i dt. 10.07.2020 është konstatuar se pretendimi ynë ankimor është i bazuar dhe ky pretendim është cilësuar si çështje e gjykuar (Res-judicata), mirëpo edhe pas të gjitha këtyre vendimeve të OSHP-së ku është ri konfirmuar përgjegjëshmëria e OE të rekomanduar për kontratë, AK-ja po vazhdon të na diskriminoj neve si OE i përgjegjshëm ndërsa po e favorizon OE e rekomanduar për kontratë një OE i cili në disa vendime është cilësuar si i papërgjegjshëm, duke mos i respektuar fare vendimet e OSHP-së edhe pse AK-ja është e detyruar ti respektoj këto vendime. Pra autoriteti kontraktues edhe me këtë vlerësim ka vepruar plotësisht në kundërshtim me vendimet e lartcekura të OSHP-së duke e rekomanduar për kontratë OE Drini Company SH.P.K, edhe pse është konfirmuar përgjegjëshmëria e këtij operatori ekonomik me vendimet e një organi më të lartë administrativ siç është OSHP-ja.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr.01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar me parë me Vendimi i PSH.nr.400/19 dhe 419/19 datë 06.09.2019; Vendimi i PSH nr.621/19 datë 07.11.2019; Vendimin e PSH.nr.829/19 datë 27.12.2019, Vendimin e PSH.nr.85/20 datë 11.03.2020 dhe Vendimin e PSH.nr.346,348/20 datë 10.07.2020, ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit teknik të prokurimit vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "EUROASPHALT" SH.P.K, se në vendimin e OSHP-së Nr.85/20 të dt.11.03.2020 është konstatuar se edhe kontrata e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë me titull "reconstruction of road Kukës Shishtavec Lot 2 Kukës Region me Nr. CËC/ICB/2013/ËL- rec-54-1 është lidhur me dt.28.04.2014 dhe ka përfunduar me dt. 30.06.2016 dhe nuk mund të merret parasysh, me përjashtim të situatës të fundit eventuale, e të cilin nuk e ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë, prandaj kjo kontratë nuk mund të merret parasysh si valide dhe në kuadër të tri viteve të fundit siç është kërkuar nga ana e AK-së, sepse njoftimi për kontratë është bërë me dt. 10.05.2019, ndërsa faktin se pretendimi ynë është i bazuar e ka vërtetuar edhe një herë paneli shqyrtues i OSHP-së në vendimin nr. 346-348/20 i dt. 10.07.2020, andaj është për tu habitur se si mundet që përsëri të rekomandohet për kontratë një OE papërgjegjshmërinë e të cilit e ka konstatuar paneli shqyrtues në vendimin e fundit dhe në vendimet tjera të mëhershme. Ky veprim i AK-së nuk mund të merret ndryshe përveç se favorizim i hapur ndaj OE të rekomanduar për kontratë, diskriminim i kompanisë tonë dhe mos respektim i vendimeve të organit më të lartë në këtë rast OSHP-së.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Pra, ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH.nr.829/19 datë 27.12.2019, Vendimin e PSH.nr.85/20 datë 11.03.2020 dhe Vendimin e PSH.nr.346,348/20 datë 10.07.2020, ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit teknik të prokurimit vjen në përfundim se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Prandaj, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Ndërsa, sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues "EUROASPHALT" SH.P.K, se OE i rekomanduar për kontratë Drini Company Shpk" sh.p.k nuk ka ofruar dëshmi konkrete edhe për projektet si në vijim: I. Asfaltimi i rrugës Pastasel -Kaznik me Nr. Prot: 623.14.018.521 Autoriteti K.K Rahovec. Vlera e kontratës 20,640.00 €, e filluar me 26.06.2014 e përfunduar 19.07.2016, nuk ka dëshmi për shumën e realizimit-pagesa për vitin 2016.

2.Referenca e dëshmuar e kontratës Rehabilitimi me asfalt i rrugëve në komunën e Prizrenit 19.97 për njësi, nuk përputhet me titullin e kontratës, është lëshuar për :Adoptimi i pompave me asfalt në qytet dhe fshatra të Prizrenit.

3. Nuk është vëlosur referenca e lëshuar me dt. 07.03.2019 nga Investitori MI-se në kontratën " Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve Nacionale dhe Rajonale për vitin 2016-2017 Regjioni Prizrenit -2 me Nr. Prot MI-14/051/211

4. Nuk është vulosur referenca e lëshuar me dt :07.03.2019 nga Investitori MI-se ne kontratën "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve Nacionale dhe Rajonale për vitin 2017-2018 Regjioni Prizrenit -2 me Nr. Prot. MI 205/17/5353/215.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë vërehet që OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar edhe kërkesën në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional ku është kërkuar "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 5.000.000,00€, ne rast konzorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme.

OE i rekomanduar për kontratë ka gabime aritmetikore ashtu siç e ka cekur kryesuesi i komisionit të vlerësimit tek lëshesa pllakore në stacionazhet 1+416 km dhe 2+922 km të punët e armimit, nuk është mbledh pozicioni V.I. Furnizimi, punimi dhe vendosja e armaturës nga $\Phi 10$ mm deri në $\Phi 16$ mm: $21368.90 \text{ kg} \times 0.80 = 17,095.12$ €.

Tek rekapitullimi i lëshesës pllakore totali del gjithsej me TVSH 69,795.72 € e jo 52,700.60 € sikur në ofertë. ne total kontrata nuk është 2,999,470.37 € por 3,016,565.50 €.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të rregullores nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit , neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Pra, ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH.nr.346, 348/20 datë: 10.07.2020 ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e eksperti teknik të prokurimit vjen në përfundim se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Pastaj, lidhur me pretendimin e OE ankues "EUROASPHALT" SH.P.K, se OE i rekomanduar për kontratë "Drini Company" sh.p.k nuk e ka plotësuar edhe kërkesën e nenit 8.1&8.2 të FTD-së përkitazi me Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, ku është kërkuar "Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 500.000,00 € asete likuide financiare (për shembull në llogarinë bankare) ose të paktën 500.000,00 € qasje për kredi në dispozicion.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një deklaratë nga Banka Raiffeisen Bank, ku shkruan se mundet me mbështet kompaninë për kredi nëse i plotëson kriteret e brendshme të Bankës, mirëpo kjo deklaratë nuk është në përputhshmëri me kërkesën e FTD-së dhe nuk po konfirmon qasjen në dispozicion për kredi, pasi që ky dokument mund ti lëshohet secilit dhe secili person juridik apo fizik mundet të merr kredi nëse i plotëson kushtet dhe kriteret e brendshme të bankës. Por në këtë rast nuk po konfirmohet se i plotëson OE i rekomanduar për kontratë kushtet për kredi në vlerën e kërkuar. Prandaj për të sqaruar këtë dokument të OE të rekomanduar për kontratë AK-ja ka mundur shumë lehtë të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2

dhe 72 të LPP-së nga Banka e cila e ka lëshuar këtë dokumente dhe të vërtetohet se a posedon “Drini company” Sh.p.k. mjete likuide apo qasje të pakushtëzuar në kredi. Pasi që këtë veprim AK-ja nuk e ka ndërmarr gjatë rivlerësimit të ofertave kërkojmë që të detyroni AK tani pas ankesës të kërkoj sqarimet nga Banka, sipas dispozitave që i cekëm më lartë. Për të bërë ekzaminim, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave AK-ja duhet të bëj kërkesë drejtpërdrejtë nga banka për të konfirmuar dëshminë e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë dhe të vërtetohet saktë se a është kjo dëshmi sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke u bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Pra, ky pretendim është shqyrtuar më parë me Vendimin e PSH .nr. 346, 348/20 datë: 10. 07. 2020 ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e eksperti teknik të prokurimit vjen në përfundim se ky pretendim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “EUROASPHALT” SH.P.K, në lidhje me arsyen e AK-së për eliminimin tonë ju sqarojmë se arsyetimi i AK-së është i pa bazuar pasi që ne e përmbushim kërkesën në lidhje me 60% kontrata të ngjashme, sepse AK-ja tek lista e projekteve të prezantuar nga ne, nuk e ka llogaritur fare kontratën me titull Ndërtimi Ekzekutimi i pllatos së Qendrës Tregtare-Prizren e cila kontratë ka shifrën prej 251,573.30 €, ndërsa në kuadër të kësaj kontratë hyn edhe aneks kontrata me titull Punimi i pllatos (parkingut) me asfalt për Qendrën Tregtare-Prizren e cila e ka vlerën prej 80,000.00 €, e ku të dyja këto e kapin vlerën prej 331,573.30 €, vlerë kjo që dëshmon se lideri e plotëson kërkesën e FDT-së prej 60 % të vlerës së kontratave. Ju sqarojmë se gjatë dorëzimit të ofertës ka ndodhur një lëshim teknik nga ana jonë ku nuk është bashkangjitur referenca ose pranimi teknik i kësaj kontrate, mirëpo AK-ja nëse ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me kontratën e lartpërmendur atëherë ka mundur që në bazë të dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-s të kërkoj sqarime shtesë nga ne dhe jo automatikisht të na eliminoj. Ne lidhje me këtë kontratë ekzistojnë referenca dhe procesverbali i pranimi teknik i aneks kontratës, ndërsa po ashtu ekzistojnë edhe dëshmitë bankare me të gjitha pagesat që janë bërë për këtë kontratë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktuese ka qenë i obliguar të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së, si dhe nenit 39.8 të RRUOPP në bazë të cilit AK-ja duhet të bëjë sqarimin e tenderëve.

Problemi	Si te veprohet?	Neni i LPP-se
Mungon referenca/certifikata e pranimi nga lista e kontratave te prezantuara	Mund te kërkojen informata sqaruese	69

Prandaj, ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e fundit të OE ankues “EUROASPHALT” SH.P.K, se duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Në raportin e rivlerësimit të VI me radhë vërehet edhe një mospërputhje e mendimeve të anëtarëve të komisionit, sepse Kryesuesi i komisionit ka rekomanduar që të anulohet në tërësi ky aktivitet i prokurimit, ndërsa dy anëtarët tjerë kanë rekomanduar që të rekomandohet për kontratë OE Drini Company dhe duke e cilësuar si devijim të vogël ofrimin e diplomës bachelor në vend të diplomës Inxhinier të komunikacionit. Te dy anëtarët e komisionit e japin një mendim ku konstatojnë se OE “Drini Company” sh.p.k. është operatori ekonomik më i përgjegjshëm për zbatim të këtij projekt, pra edhe këta dy anëtarë të komisionit faktikisht e pranojnë që OE Drini nuk është i përgjegjshëm por thonë se është më i përgjegjshmi. Në raport me OE Drini Company dy anëtarët e komisionit kanë shpreh subjektivizëm ekstrem duke mos i bërë përshtypje dokumentet të cilat nuk janë në rregull, as vula në referencë e as diploma, e as vendimet e një organi më të lartë siç është OSHP-ja që ka konstatuar se OE Drini Company është i papërgjegjshëm.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të raportit të rivlerësimit të VI të tenderëve ka një mospërputhje e mendimeve përfundimtare të anëtarëve të komisionit, si: Kryesuesi i komisioni për Ri-vlerësimin e VI-të, z. Arbër Ramadani, ka qenë i mendimit se asnjëri nga operatorët ekonomik nuk i plotëson kriteret e kërkuara nga autoriteti kontraktues, prandaj ka kërkuar që tenderi të anulohet dhe të shkohet me ri-tenderim. Kurse, dy anëtarët tjerë të komisionit për ri-vlerësimin e VI-të, z. Luan Nimani dhe z. Berat Bejtullahu, kanë qenë të mendimit se operatori ekonomik më i përgjegjshëm me çmimin më të ulët është SH. Drini Company SH.P.K., Ersan Mazreku Lam 2/1, -20000, PRIZREN, të cilin e rekomanduan me dhënie të kontratës. Andaj, rekomandimi i kryesuesit të komisionit ka qenë i drejtë kurse rekomandimi i të dy anëtarëve të komisionit ka qenë jo real sepse janë vetëm dy opsione, i përgjegjshëm ose i pa përgjegjshëm kurse vlerësimi “më i përgjegjshëm” nuk ekziston sipas LPP-së. Andaj, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarimeve të ekspertit shqyrtues dhe vendimeve paraprake të Panelit Shqyrtues për këtë aktivitet të prokurimit, vjen në përfundim se AK nuk ka marrë për bazë sqarimet e dhëna në vendimet paraprake të Panelit Shqyrtues, ku për shumicën e pretendimeve ankimor tanimë veç është vendosur. Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se me rastin e ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve nga autoriteti kontraktues, nuk janë marrë parasysh kriteret e dosjes së tenderit dhe kjo ka rezultuar me shkelje të nenit 59 të LPP-së. Për më tepër, duke pasur parasysh ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit dhe të metat në ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve nga ana e AK-së, Paneli Shqyrtues i tërheq vërejtjen autoritetit

kontraktues që ti respektoj vendimet e Panelit Shqyrtues dhe të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform dispozitave të LPP-së. Në të kundërt, AK e detyron Panelin Shqyrtues që të ndërmarr masa konform LPP-së. Andaj,

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Blerina Dina



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Gjakovë" (KK.GJ),
- 1x1 OE "Pe-Vla-Ku" SH.P.K- Dega në Kosovë-Prishtinë
- 1x1 OE "Euroasphalt" SH.P.K- Gjakovë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.